

INDEKSI I PRODHIMIT NË NDËRTIM

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
4. Njësia matëse	3
5. Periudha e referencës	3
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	5
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	5
11. Manaxhimi i cilësisë	6
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	11
19. Komente.....	12
Aneks	12

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dhe Turizmit Pranë Ndërmarrjeve, Drejtoria e Statistikave Ekonomike
1.3. Personi i kontaktit	Klodiana Gurra
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave Afatshkurtra dhe Turizmit Pranë Ndërmarrjeve
1.5. Adresa postare	Rruga Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	kgurra@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	19.03.2026
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	19.03.2026
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	19.03.2026
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Indeksi i Prodhimit në Ndërtim është një tregues afatshkurtër i rëndësishëm ekonomik i cili ka për qëllim të masë ndryshimet tremujore të prodhimit të ndërtimit ndërmjet dy periudhave të krahasueshme. Ky informacion mund të përdoret për të analizuar, gjendjen aktuale të aktivitetit të ndërtimit në vend si dhe parashikimin afatshkurtër për zhvillimin e ardhshëm të këtij sektori.</p> <p>Burimi kryesor është Vrojtimi Tremujor i Statistikave Afatshkurtra, Pyetëtori për aktivitetin e Ndërtimit (Moduli 122), kombinuar me të dhëna administrative. Të dhënat e mbledhura me anë të këtij kërkimi janë orë reale të punuara nga personat e punësuar që janë të angazhuar direkt në procesin e prodhimit në ndërtim – gjithsej dhe veçmas sipas llojit (ndërtimin e ndërtesave dhe punimeve inxhinierike).</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi statistikor i aktiviteteve ekonomike bazohet në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev.2
3.3. Mbulimi i sektorit	Vrojtimi (për këtë tregues) përfshin ndërmarrjet e regjistruara në Seksionin F të

	NVE Rev. 2. Anketa përfshin të gjitha ndërmarrjet e mëdha e të mesme, si dhe një numër përfaqësues të ndërmarrjeve të vogla. Një shtresë përcaktohet sipas klasave dhe bazohet në numrin e të punësuarve.
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	<p>Objektivi i Indeksit të Prodhimit në Ndërtim është të masë ndryshimet në volumin e prodhimit në intervale të rregullta, kryesisht tremujore dhe vjetore. Ai mundëson matjen e trendit të volumit në vlerën e shtuar gjatë një periudhe të caktuar referimi. Indeksi i prodhimit është një matës teorik që duhet të përafrohet me matjen praktike.</p> <p>Vlera e shtuar me çmime bazë mund të llogaritet nga shitjet neto (pa TVSH dhe taksat të tjera të ngjashme të zbritshme të lidhura drejtpërdrejt me shitjet neto):</p> <ul style="list-style-type: none"> • + prodhim i kapitalizuar; • + të ardhura të tjera operative; • +/- ndryshimet në stok; • - blerjet e mallrave dhe shërbimeve; • - taksat për produktet të cilat janë të lidhura me shitjet neto, por nuk zbriten; • + çdo subvencion për produktet e marra.
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është ndërmarrja.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore përfshin njësitet statistikore, në këtë rast ndërmarrjet, të cilat operojnë në aktivitetet ekonomike sipas NVE Rev.2. Ndërtim (seksioni F, ndarjet 41-43). Ndërmarrjet me 1-9 të punësuar janë vrojtuar me kampion, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë vrojtuar tërësisht.
3.7. Zona e referencës	Indeksi i Prodhimit në Ndërtim mbulon të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Vrojtimi tremujor i Statistikave Afatshkurtra referuar Indeksit të Prodhimit në Ndërtim daton prej vitit 2005 e në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Duke filluar nga tremujori i parë 2024, aplikohet viti bazë 2021 (2021 = 100).
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Njësitet matëse janë indekset dhe ndryshimet në përqindje (%).
5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Informacioni i grumbulluar dhe përpunuar i referohet periudhave tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2025.

6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Bazat ligjore ku mbështeten indikatorët e Statistikave Afatshkurtra janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”; • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare, 2022-2026. <p>Klasifikimet dhe Përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja (BE) 2019/2152 për Statistikat Evropiane të Biznesit; • Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2020/1197 e cila përcakton variablat dhe shpeshhtësinë e përpilimit të të dhënave, shfuqizimi i porosive të reja të marra për ndërtimin e ndërtesave dhe porositë e reja të marra për inxhinierinë civile.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	<p>Shkëmbimi i të dhënave për Statistikat Afatshkurtra ka filluar në tremujorin e tretë 2017 në nivelin Evropian. Nga tremujori i parë i vitit 2018 të dhënat për Indeksin e Prodhimit në Ndërtim transmetohen rregullisht në Eurostat.</p>
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018, "Për Statistikat zyrtare", si dhe Ligj Nr. 124/2024 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Neni 31, i ligjit "Për Statistikat zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga Instituti i Statistikave vetëm në rast se:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave; <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore</p>

	<p>dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahe dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendarin e publikimeve	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat njoftohen paraprakisht në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve	<p>Kalendarin e publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>
8.3. Aksesin i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	
9.1 Shpeshësia e shpërndarjes	<p>Indeksi i Prodhimit në Ndërtim shpërndahet me bazë tremujore.</p>
10. Aksesin në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	<p>Sipas kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Statistikat Afatshkurtra. Formatin e njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Statistikave Afatshkurtra publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.</p>

10.2. Publikime	Përdoruesit mund t'i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT nën nëntemën: Statistikat Afatshkurtra .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e Statistikave Afatshkurtra. Gjithashtu në faqen interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: Databaza Statistikore .
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Të dhënat e Statistikave Afatshkurtra nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018, datë 17.04.2018 "Për statistikat zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodologjinë mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dhe Turizmit Pranë Ndërmarrjeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ATN për qëllime të brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat zyrtare”, datë 05.04.2018”. INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane . INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.

11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Kontrollet e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Stafi ka përvojën e duhur për përlogaritjen e indeksit dhe është i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të tij.</p> <p>Rregullisht kryhet një krahasim me të dhënat e vitit të kaluar për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënave apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdorues janë klasifikuar në të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <p>Përdoruesit e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ministritë dhe administrata publike që përdorin të dhënat për qëllime të planifikimit të politikave ekonomike dhe sociale; • Universitetet (profesorë / studentë të diplomuar dhe pasuniversitar), organizata kërkimore; • OJQ Kombëtare dhe Ndërkombëtare; • Ndërmarrjet; • Publiku i gjerë që merr informacionin përmes mediave nëpërmjet publikimeve të bëra nga Zyra e Statistikave. <p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Llogarive Kombëtare; • Sektori i Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve; • Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>INSTAT kryen çdo vit vërtetimin për Matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve, rezultatet e të cilit do të publikohen në web e INSTAT në linkun Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Statistikave Afatshkurtra në tërësinë e tyre ndërtohen në përputhje me rregulloret e Eurostat. Shkalla e plotshmërisë së të dhënave për vërtetimin e Statistikave Afatshkurtra për vitin 2025 është 62,0 %. Kjo llogaritje mori parasysh rregulloren evropiane. Si rezultat, llogaritja e Indeksit të Prodhimit në Ndërtim dhe të dhënat e siguruar janë në përputhje me Rregulloret përkatëse të BE-së.</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave.</p> <p>Popullata e vëzhguar e Statistikave Afatshkurtra 2025 përfshin afërsisht 11,462 ndërmarrje për çdo tremujor nga të cilat afërsisht 1,200 ndërmarrje në aktivitetin e Ndërtimit. Dizanji i kampionimit është kampionim i thjeshtë i rastësishëm, i</p>

	<p>shtresëzuar. Kriteri i përdorur për shtresëzim është numri i personave të punësuar sipas NACE Rev.2 në nivel 3 shifror.</p> <p>Llogaritja e vlerësimeve të të dhënave statistikore dhe analiza e njësive outlier kryhet rregullisht. Duke marrë parasysh shkallën e lartë të përgjigjes, shkalla e saktësisë së përgjithshme është e lartë. Për të llogaritur vlerësimet, përdoret vlerësuesi Horvitz-Thompson, që është i paanshëm. Saktësia e vlerësimeve arrihet duke eliminuar gabimet e kampionimit dhe të jo kampionimit, të tilla si mbulimi, pa përgjigje, gabimet e përgjigjes dhe gabimet e përpunimit.</p> <p>Arsyet e shfaqes së gabimeve në mbulim janë: keq klasifikimi i njësive dhe ndryshimeve në statusin e njësive raportuese. Është e detyrueshme t'i përgjigjesh vrojtimit. Në rast mos-përgjigje, njësitë kontaktohen përmes telefonit dhe postës elektronike. Gabimi në kampionim në përqindje (CV) llogaritet për treguesit kryesorë të vrojtimit që publikohen çdo tremujor.</p>						
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Gabimet e kampionimit trajtohen në raportet e brendshme teknike, ku për çdo indikator në vrojtimit llogaritet varianca e totalit, si dhe gabimi standard relativ, për eliminimin e efektit negativ që jep lëvizja e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes në serinë kohore të vlerave. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.</p>						
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Mos-përgjigja e njësisë merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje ose nuk duan të japin përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje të gjejnë adresën e ndërmarrjeve, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën.</p> <p>Shkalla e mos-përgjigjes në nivel rekordi mesatarisht për ATN 2025 është 2,44%.</p>						
14. Afatet kohore dhe përpikmëria							
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Indeksit të Prodhimit në Ndërtim janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 78 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 78 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Indeksi i Prodhimit të Ndërtimit është 31 Dhjetori 2025.</p> <table border="1" data-bbox="443 1563 1027 1706"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2025</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/19/2026</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>78</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2025	Data e publikimit	3/19/2026	Afatet kohore	78
Periudha referuese	12/31/2025						
Data e publikimit	3/19/2026						
Afatet kohore	78						

14.2. Përpikmëria	Të dhënat e Indeksit të Prodhimit në Ndërtim, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i “Statistikave Afatshkurtra – Prodhuesit e të mirave” ka qenë i perpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.	
	Periudha referuese	12/31/2025
	Data e shpallur	3/19/2026
	Data e publikimit	3/19/2026
	Vonesa në kohë	0

15. Koherenca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi treguesit e Indeksit të Prodhimit në Ndërtim janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi.
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Ndër vite Indeksi i Prodhimit në Ndërtim në Anketën Tremujore pranë Ndërmarrjeve ka pësuar ndryshime në fushën e mbulimit dhe në metodën e zgjedhjes. ATN-ja ka filluar për herë të parë në vitin 2005. Ndërmarrjet më 1-9 të punësuar janë me kampionim, ndërsa ndërmarrjet me mbi 10 të punësuar janë marrë me listim (në mënyrë të plotë) pa ndryshuar fushën e mbulimit. Në vitin 2012 popullsia e Indeksit të Prodhimit në Ndërtim ndryshon si rezultat i përditësimit të Rregjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve me rezultatet e Rregjistrimit të Ndërmarrjeve Ekonomike, 2010. Të gjitha ndryshimet janë raportuar në shpjegimet metodologjike që shoqërojnë publikimet përkatëse. Në vitin 2014 në Indeksin i Prodhimit në Ndërtim u implementua nomenklatura e aktiviteteve ekonomike, NVE Rev. 2, struktura e azhornuar e peshave dhe ndryshimi i periudhës bazë të indekseve nga 2005 në 2010. . Në vitin 2019 periudha bazë e indekseve ndryshoi nga 2010 në 2015. Në vitin 2024 në SASH përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2015 në 2021. Të gjitha këto ndryshime në serinë e indekseve nuk janë shkëputur, por indekset janë kthyer mbrapa në kohë. Këto ndryshime janë raportuar në shpjegimet metodologjike që bashkohen me botimet përkatëse. Të dhënat e Statistikave Afatshkurtra sipas tremujorëve bazuar në Klasifikimin e Aktivitetit Ekonomik NVE Rev 2, datojnë që nga viti 2006 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 20 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=20).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Indeksi i Prodhimit në Ndërtim është vlerësuar duke përdorur të dhënat e TVSH. Për ndërmarrjet që të dhënat e TVSH nuk janë të disponueshme është përdorur vrojtimi me zgjedhje. Nuk ekziston informacion tjetër statistikor i cili mund të përdoren për kontrollin e koherencës.

15.4. Koherenca e brendshme	Koherenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar përpara se ato të finalizohen. Lidhja midis variablave është kontrolluar dhe koherenca midis serive të ndryshme të të dhënave është konfirmuar. Specialistët e Statistikave Afatshkurtra punojnë së bashku me specialistë të drejtorive përkatëse për të siguruar qëndrueshmërinë dhe koherencë të treguesve statistikor.
16. Kostoja dhe ngarkesa	
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	<p>Kostoja e Statistikave Afatshkurtra përfshin informacion mbi numrin e stafit të përhershëm dhe të përkohshëm. Numri i stafit të ATN është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Totali i stafit në Zyrën Qendrore: 1 punonjës; • Specialistët e logjistikës: 1 punonjës; • Anketues 124 të punësuar; • Kontrollorë 2 të punësuar. <p>Transmetimi i të dhënave administrative mundësohet pa kosto përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkuara midis INSTAT, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT). Burimet Statistike si (Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ATN e mëparshme) janë gjithashtu pa kosto, pasi janë konsideruar si përdorues të brëndshëm. Stafi i ATN menaxhon kontrollin dhe analizën e të dhënave, kështu që edhe këto dy proçese nuk kanë kosto të tjera shtesë.</p>
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit; • Politika e trajtimit të gabimeve. <p>E njëjta politikë revizionimi është aplikuar në publikimet në nivel kombëtar dhe transmetimeve në Eurostat.</p>
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare ato mund të rishikohen. Të dhënat mund të rishikohen për një sërë arsyesh si: implementimi i klasifikimit të ri NVE, ndryshime metodologjike, burime të reja informacioni ose të përmirësimeve të të dhënave dhe korrigjime të gabimeve. Rishikimi i tremujorit paraardhës është i mundur të kryhet gjatë çdo tremujori dhe në fund të çdo viti mund të kryhen korrigjime për të katërt tremujorët.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Indeksi i Prodhimit në Ndërtim” për vitin 2025. Nuk ka vlerësime numerike të indikatorëve MR dhe MAR.</p>

18. Përpunimi statistikor

18.1. Burimi i të dhënave	<p>Të dhënat bazohen në anketat statistikore tremujore dhe të dhënat administrative. Baza e përzgjedhjes është Regjistri i ndërmarrjeve aktive për vitin referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NVE Rev. 2. Popullata në studim përcaktohet nga dy kriteret themelore: madhësia e ndërmarrjes (bazuar në numrin e të punësuarve) dhe aktiviteti ekonomik brenda fushës së studimit, me prerje. Metoda e përzgjedhjes së përdorur është Përzgjedhje e Thjeshtë e Rastit me Shtresëzim (SRS). Shtresëzimi bazohet në kombinimin e aktivitetit ekonomik me grupin e madhësisë së ndërmarrjes. Treguesit janë paraqitur për aktivitete ekonomike sipas fushave të përcaktuara në rregulloren e Statistikave Afatshkurtra dhe gjithashtu bazuar në nevojat e përdoruesve.</p>
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	<p>Të dhënat grumbullohen çdo tremujor.</p>
18.3. Grumbullimi i të dhënave	<p>Gjatë vitit 2025, të dhënat janë siguruar në mënyrë të kombinuar nëpërmjet burimeve administrative dhe intervistimit të drejtpërdrejtë nga anketuesit pranë ndërmarrjeve. Kohëzgjatja e intervistimit të drejtpërdrejtë ishte 15 ditë pas tremujorit referues dhe u krye vetëm për ndërmarrjet të cilat nuk ishin subjekt i deklaramit në burimet administrative. Gjatë vitit referencë nuk është planifikuar ndryshim në pyetësor.</p>
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Të dhënat e marra nga vrojtimi dhe nga skedari i TVSH-së vlerësohen duke përdorur rregulla logjike të vlefshme.</p> <p>Në nivel kombëtar, editimi përfshin studimin e të dhënave të të anketuarve me qëllim identifikimin (dhe korrigjimin) e gabimeve. Jo të gjitha gabimet mund të identifikohen, por qëllimi është të zbulohen ato gabime që kanë ndikim të madh tek rezultatet.</p> <p>Rregullat për identifikimin e gabimeve mund të vënë në dukje gabime të mundshme të cilat kërkojnë një studim të mëtejshëm për të kuptuar se ku qëndron gabimi përkundërt një rezultati të pazakontë ose mund të evidentojnë gabime të përcaktuara. Redaktimi (editimi) përfshin kontrollin për tërësinë, që vlerat janë brenda kufijve të caktuar dhe se vlerat për variablat e lidhur janë koherente. Redaktimi i të dhënave mund të bëhet gjatë ose pas hedhjes së të dhënave. Përgjigjet mund të krahasohen me përgjigjet e tremujorëve të mëparshëm. Mospërputhja ose devijimet e mëdha (jashtë një diapazoni të paracaktuar) tregojnë se një studim më i thellë do ishte i rëndësishëm. Kjo mund të rezultojë në redaktim të dhënash. Në kontekstin e afatit kohor, procesi i redaktimit mund të jetë i dizajnuar për t'i dhënë përparësi kryesore atyre njeshi outlier që kanë më shumë nevojë për redaktim për hir të agregateve të besueshëm. Me zgjidhjen e</p>

	rasteve më të këqija, mund të arrihen përmirësime të mëdha.
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Nivel Kombëtar</p> <p>Hapi i parë është mbledhja e informacionit nga burimet administrative dhe intervistat e drejtpërdrejta pranë ndërmarrjeve. Qëllimi është për të sjellë këtë informacion në nivelin statistikor. Proçesi i ndjekur është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli logjik i informacionit të mbledhur me intervistim (kontrolli i shënjitimit logjik të indikatorëve të përgjigjes si dhe kontrolli i plotësisimit të shifrave); • Pas hedhjes së të dhënave, gabimet dhe mospërputhjet evidentohen dhe korrigjohen përgjatë redaktimit (editimit); • Krahasueshmëria e të dhënave (analizë e të dhënave me periudhat e mëparshme ose trendet); • Analiza e rezultateve për çdo fushë publikimi (domein); • Rezultatet e plota dhe të pastra të të dhënave shërbejnë më pas për fazën e peshimit dhe ri-peshimit; • Të dhënat e agreguara krahasohen me të dhëna nga burime të tjera; • Dy fazat e fundit mund të jenë subjekt analizash të tjera, në funksion të rezultateve sipas fushave të publikimit (domein-et); <p>Së fundi, kur analiza statistikore ka përfunduar, këto të dhëna përcaktohen si grup informacioni jo-publike. Para shpërndarjes së rezultateve, fazë shumë e rëndësishme është ruajtja e konfidencialitetit të këtij informacioni.</p>
18.6. Rregullimi	<p>Indeksi i Prodhimit në Ndërtim llogaritet i përshtatur sezonalisht dhe i papërshtatur sezonalisht. Përshtatja sezonale e serive kohore tremujore të Ndërtimit u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.4. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore 2006 - 2025. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative) dhe qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.</p>
19. Komentë	
Aneks	